

## KONGRESI i 3 Botëror i ITUC, Berlin, Maj 2014

*Haxhi Arifi*  
*Kryetari i BSPK-së*

*Fjalimi për media europiane me 22.05.2014*

Rritja e organizimit Sindikal, realizimi i të drejtave të punëtorëve dhe krijimi i vendeve të qëndrueshme të punës janë tri motot me të cilat ky kongres po i zhvillon punimet këtë vit.

Këto janë problemet me të cilat sot ballafaqohen punëtorët edhe në Kosovë. Faza e tranzicionit që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008 në kombinim me një politikë neoliberaliste kanë rezultuar me një numër të madh të të papunëve dhe rrjedhimisht edhe një dobësim të organizimit sindikal, trend ky që si duket po dominon edhe në sindikatat evropiane dhe botërore. Nuk është e nevojshme të theksoj se dobësimi në organizimin sindikal sjell me vete edhe dobësimin e sindikatave që është edhe në interesin e politikës neoliberale.

Nga përvoja dhe nga kontaktet që kemi si BSPK me sindikatat e ndryshme në ballkan dhe evropë kemi ardhur në përfundim se domosdoshmërisht duhet të ndodhë një ndryshim radikal në qasjen e organizimit sindikal në tërë evropën. Derisa në Bashkimin Evropian kemi shtete që kanë ligje shumë të avancuara për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, apo kontrata kolektive shumë të mira në anën tjetër kemi shtete ku këto ligje nuk egzistojnë fare apo nuk funksionojnë dhe mekanizmat për zbatimin e këtyre ligjeve thjeshtë mungojnë.

Ne mendojmë se rritja Ekonomike e secilit shtet nuk duhet të jetë në funksion të kapitalit por në interes të punëtorëve dhe kjo shkon edhe në dobi të kompanive. Organizimi sindikal i jep punëtorëve fuqinë kolektive karrshi punëdhënësit kundrejt ligjeve të punës që e individualizojnë dhe trajtojnë punëtorin si individ ndërsa organizimi i mirëfillt sindikal e jap fuqinë e duhur e cila fuqi i ndihmon edhe punëdhënësit. Kompanitë që kanë të bëjnë me punëtor të organizuar detyrimisht do të zhvillojnë strategji afatgjata dhe do të jenë bashkë me punëtorin e jo kundër tij. Kjo në aspektin afatgjatë vetëm sa do të ndihmojë në rritjen dhe zhvillimin e këtyre kompanive e me këtë edhe mirëqenien e punëtorëve.

Me qarkullimin e lirë të njerzëve brenda Bashkimit evropian janë shtuar edhe mundësitë e keqpërdorimit të fuqisë punëtore nga vendet më pak të zhvilluara në vendet më ekonomit të zhvilluara duke shkaktuar edhe fenomenin e dampingut të pagave. Ky fenomen sjell me vete edhe problem tjera si humbjen e vendeve të punës dhe zvogëlimin e pagave.

Jemi të bindur se një partneritet social mes qeverive dhe sindikatave është çelësi i vënies në jetë të tri motive të këtij Kongresi. Krijimi i një platforme komunikuese dhe bashkërendimi i aktiviteteve mes sindikatave nga shtetet e bashkimit evropian do të ishte një fillim i mbarë. Trajnimet e ndryshme për

sindikatat në shtetet që gjenden në tranzicion do të ndihmonin shumë në forcimin dhe pavarësimin e këtyre sindikatave. Përvoja e juaj shumëvjeqare do të na e shkurtonte rrugën tone në formësimin e sindikatave të fuqishme me antarësi të forte që do të mbronte denjësisht të drejtat e tyre.

Në fund ju dëshiroj mbarvajtje të punëve në kongres dhe shumë suksese në luftën tone të përditshme drejt forcimit të sindikatave, realizimit të së drejtave të punëtorëve dhe krijimin e vendeve të qëndueshme të punës.

Ju faleminderit për vëmendjen